NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 19 nëntor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U miratua procesverbali i mbledhjes së Bordit të ERE-s nr. 48, datë 06.11.2026.

- LICENCIMI DHE MONITORIMI I SUBJEKTEVE

Vendimmarrjet e Bordit të ERE-s:

"SHPËRDHAZA ENERGJI" sh.p.k. – Bordi i ERE-së miratoi licencimin e shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Arrëz", me kapacitet të instaluar 1.613 MW, me vendndodhje në ujërat e lumit Shpërdhazë, Komuna Kaçinar, Rrethi Mirditë, me afat vlefshmërie të licencës deri më 20.09.2050. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 10.12.2026.

"EURON SOLAR-PV" sh.p.k. – Bordi i ERE-së miratoi licencimin e shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 100 MWp dhe fuqi 85 MW AC, me vendndodhje në fshatrat Fushë dhe Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar, duke përcaktuar datën 27.05.2029 për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë.

"MATEO&CO" sh.p.k. –Bordi i ERE-s miratoi ndryshimin e vendimit nr. 155, datë 07.10.2020, duke rishikuar detyrimet e shoqërisë në lidhje me dokumentacionin që duhet të depozitojë pranë ERE-s në kuadër të lejes së përdorimit të burimit ujor., si dhe duke hequr detyrimin për paraqitjen e kontratës së rinovuar të qirasë.

"KURUM INTERNATIONAL" sh.a. – Bordi i ERE-s miratoi ndryshimin e vendimit nr. 150, datë 28.04.2023, duke rishikuar detyrimet e shoqërisë lidhur me dokumentacionin që duhet të depozitojë pranë ERE-s, duke rishikuar detyrimet e shoqërisë lidhur me dokumentacionin që duhet të depozitojë pranë ERE-s, si dhe duke përcaktuar kushtet për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike në rast të ndërprerjes së tij nga organet kompetente.

Regjistrohen tre impiante të reja të depozitimit të energjisë elektrike

Në vijim të zbatimit të dispozitave kalimtare të ligjit nr. 59/2026, Bordi i ERE-s miratoi regjistrimin e tre impianteve të depozitimit të energjisë elektrike, të deklaruara nga shoqëritë "SPV Blue 1" sh.p.k., "NAD Investment" sh.p.k. dhe "Smart Watt" sh.p.k.

Impiantet e regjistruara kanë këto karakteristika:

-“SPV Blue 1” sh.p.k. – fuqi ngarkimi 50 MW fuqi shkarkimi 150 MW dhe kapacitet depozitimi 80 MWh.

-“NAD Investment” sh.p.k. – fuqi ngarkimi dhe shkarkimi 20 MW dhe kapacitet depozitimi 20 MWh.

- “Smart Watt” sh.p.k. – fuqi ngarkimi 10 MW, fuqi shkarkimi 10 MW dhe kapacitet depozitimi 10 MWh.

Regjistrimi është kryer në kuadër të licencave ekzistuese të prodhimit ose tregtimit të energjisë elektrike, sipas regjimit kalimtar të parashikuar në ligjin nr. 59/2026.

Për këto impiante lejohet operimi gjatë periudhës kalimtare, deri në 12 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit, me detyrimin për aplikimin për licencën përkatëse për vijimin e aktivitetit përtej këtij afati.

Mosmiratimi i kërkesave për regjistrimin e impianteve të depozitimit të energjisë elektrike

Bordi i ERE-së vendosi të mos miratojë kërkesat e shoqërive “Sun Energy Solutions” sh.p.k. dhe “ES 2019” sh.p.k. për regjistrimin e impianteve të depozitimit të energjisë elektrike (BESS). Vendimi u mor pasi kërkesat e shoqërive janë paraqitur pas përfundimit të afatit 60-ditor të përcaktuar në nenin 51 të ligjit nr. 59/2026 për njoftimin dhe regjistrimin e këtyre impianteve.

Në vijim të çështjeve të trajtuara, Bordi i ERE-s u njoh me informacionin mbi treguesit e cilësisë së furnizimit me energji elektrike në rrjetin e shpërndarjes për 9-mujorin e vitit 2026, siç raportuar nga OSSH. Informacioni paraqiti ecurinë e këtyre treguesve gjatë periudhës raportuese, nivelin e performancës së rrjetit të shpërndarjes, si dhe problematikat e evidentuara, në funksion të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së shërbimit të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët.Në përfundim, do të ndiqen treguesit e performancës edhe në tremujorin e fundit të vitit 2026 dhe për treguesit e përmirësuar do të paraqiten propozimet për ndryshimin e treguesve në rregulloren përkatëse. Po ashtu, për problematikat e hasura do të vijojë korrespondenca me operatorin për zgjidhjen e tyre.

. Në përmbyllje, Bordi u njoh me propozimin e OST sh.a. për përcaktimin e kushteve dhe metodologjive për ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes dhe rivendosjes së sistemit elektroenergjetik mbi baza kontraktore, si dhe me ndryshimet e propozuara nga ALPEX sh.a. në Rregullat e Tregut

të Energjisë Elektrike, në funksion të përmirësimit të kuadrit rregullator për funksionimin e tregut. Gjithashtu, Bordi u njoh me informacionin mbi gjendjen e sektorit të energjisë elektrike për 9-mujorin e vitit 2026, i cili pasqyron ecurinë e treguesve kryesorë të sektorit, përfshirë bilancin elektroenergjetik, prodhimin dhe konsumin e energjisë elektrike, shkëmbimet me tregjet rajonale, aktivitetin tregtar në bursën ALPEX, zhvillimin e kapaciteteve të reja prodhuese dhe humbjet në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes. Do vijohet me korrespondencën me operatorët për saktësime në informacionet e përcjella përsa i takon disa prej të dhënave

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.